

**KËRKESË**  
**Nr. 6195, datë 21.12.2016**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën “Për shpronësim për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ura e Matit (shitesa)”, për pasuritë e llojit “drufrutorë”.

Subjekti kërkuar, i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit “drufrutorë”. Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 121 680 (njëqind e njëzet e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI I TRANSPORTIT  
DHE INFRASTRUKTURËS**  
**Bahri Shaqiri**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR**  
**“URA E MATIT (SHITESA)”**

| Pronari      |          |         |         | Z. Kad. | Nr. i pasurisë | Sip. e shpronësuar | Drufrutorë vlera (lekë) | Vlera totale (lekë) | Konfirmimi                  |
|--------------|----------|---------|---------|---------|----------------|--------------------|-------------------------|---------------------|-----------------------------|
| Nr.          | Emri     | Atësia  | Mbiemri |         |                |                    |                         |                     |                             |
| 1.           | Zylyftar | Ismail  | Lezaj   | 3882    | 466/18         | 657                | 111920                  | 111920              | Sipas vlerësimeve të DBP-së |
| 2.           | Kapllan  | Ramadan | Lezaj   | 3882    | 466/14         | 120                | 9760                    | 9760                | Sipas vlerësimeve të DBP-së |
| <b>SHUMA</b> |          |         |         |         |                |                    |                         | <b>121680</b>       |                             |